

**Përpara se një çift të paraqitet në qendrën e infertilitetit në Maternitetin
Koco Gliozheni duhen ndjekur hapat sipas Sistemit të Referimit të
shpjeguara si më poshtë :**

Ju lutemi të ndiqni hapat e mëposhtme dhe të mos telefononi SUOGJ Koco Gliozheni !

1. Si fillim çifti që dëshiron fëmijë paraqitet pranë mjekut te familjes.
2. Me referencën e mjekut të familjes çifti paraqitet pranë mjekut gjinekolog të shërbimit parësorë të zonës ku jeton . Pasi realizohen të gjitha egzaminimet e rastit mjeku gjinekolog gjykon nëse çifti vuan nga infertiliteti.
3. Pasi çifti është diagnostikuar me infertilitet përpara se të fillohet procesi i riprodhimit të asistuar , mjeku gjinekolog i shërbimit parësor duhet të vlerësojë që çifti të ketë shanse të arsyeshme për të arritur një shtatëzëni nëpërmjet aplikimit të teknikave të riprodhimit mjekësorë të asistuar duke plotësuar pyetësin.
 - a. *Pyetësi ndodhet në linkun e dytë në faqen e Qendrës së Riprodhimit Mjekësorë të Asistuar në rubrikën " Informacion rreth qendrës se riprodhimit mjekësorë të asistuar"*
4. Pas plotësimit të dokumentave përkatëse, nëse çifti plotëson kriteret e paraqitura në pyetësore ai pajiset me rekomandim për konsult specialiste për trajtimin e infertilitetit në SUOGJ Koco Gliozheni.

5. Më pas caktohet një datë dhe orë për konsultë pranë spitalit tonë SUOGJ Koco Glizoheni gjithmonë nëpërmjet sistemi të referimit.

6. Mjekët e qendrës së riprodhimit të asistuar në SUOGJ Koco Glizoheni vlerësojnë pacientin dhe e orientojnë atë drejt teknikave të duhura për trajtimin e infertilitetit.